



Administrata Tatimore e Kosovës
Poreska Administracija Kosova
Tax Administration of Kosovo

REPUBLIKA KOSOVA / REPUBLIC OF KOSOVO	
Qeveria e Kosovës / Government of Kosovo	
Ministria e Financave / Ministry of Finance	
Administrata Tatimore e Kosovës / Tax Administration of Kosovo	
KATEGORIJA: AKREDITIM E AGJENCISË	
Numri i Kartës Carta ID Org. ID	09-06-4211
Nr. i Protokollit Prot. ID	21.11.17
PRISHITINE	



Agjencia e Kosovës për Akreditim
Kosovo Accreditation Agency
Agjencia za Akreditovanje Kosova

MARRËVESHJE BASHKËPUNIMI

NDËRMEJT

ADMINISTRATËS TATIMORE TE KOSOVËS

DHE

AGJENCISË SË KOSOVËS PËR AKREDITIM

Kjo Marrëveshje Bashkëpunimi (në tekstin e mëtejshëm Marrëveshja) është e lidhur në mes palëve nënshkruese me qëllim të shkëmbimit të të dhënave në mes të dy institucioneve dhe është në përputhje me Ligjin Nr. 03/L-222 mbi Administratën Tatimore dhe Procedurat, nenin 84 (Konfidencialiteti i Informatave Tatimore) si dhe me rastin e lidhjes së Marrëveshjes janë marrë parasysh dispozitat ligjore të Ligjit Nr. 03/L-172 për Mbrojtjen e të Dhënave Personale.

Neni 1

Palët

- 1. Administrata Tatimore e Kosovës (në tekstin e mëtejshëm ATK)**, si Autoritet Ekzekutiv me autonomi të plotë operationale në kuadër të Ministrisë së Financave, e cila është përgjegjëse për zbatimin e ligjeve tatimore dhe mbledhjen e tatimeve sipas Ligjit bazik Nr. 03/L-222 për Administratën Tatimore dhe Procedurat i ndryshuar dhe plotësuar me Ligjin Nr. 04/L-102 dhe 04/L-223, e përfaqësuar nga Sakip Imeri, Drejtor i Përgjithshëm i ATK-së, dhe
- 2. Agjencia e Kosovës për Akreditim (në tekstin e mëtejshëm AKA)**, si agjenci publike për vlerësimin e cilësisë në institucionet publike dhe private të arsimit të lartë bazuar në përgjegjësitë e dhëna sipas Ligjit Nr. 04/L-037 mbi Arsimin e Lartë në Kosovë, e përfaqësuar nga z. Bekim Samadaxha, Ushtrues Detyre i AKA-së.

Neni 2

Qëllimi i marrëveshjes së bashkëpunimit

Qëllimi i kësaj Marrëveshje është shkëmbimi i të dhënave në mes të dy institucioneve, Agjencisë së Kosovës për Akreditim (në tekstin e mëtejshëm: AKA) dhe Administratës Tatimore të Kosovës (në tekstin e mëtejshëm: ATK) për të pasur qasje në databazën e ATK-së. Te dhënat do të jenë të nevojshme për identifikimin e angazhimit të stafit akademik në Institucionet e Arsimit të Lartë në Kosovë, përkatësisht të identifikimit të statusit të tyre primar dhe sekondar.

Neni 3

Fushëveprimi

Fushëveprimi i kësaj Marrëveshje është dhënia e shënimeve nga ATK për Punëdhënësin (Primare dhe Sekondare) te identifikuar me Numër Fiskal, emrin e Punëdhënësit dhe te dhëna te tjera (ne detaje do te jepen ne dokumentin teknik për këmbim te dhënave, PSO), si dhe me te dhënat e Punëmarrësit (Punëtorit) të identifikuar me Numër Personal, emrin dhe mbiemrin dhe të dhëna të tjera (ne detaje do te jepen ne dokumentin teknik për këmbim te dhënave, PSO), për periudha të caktuara kohore.

Neni 4

Rëndësia

Shkëmbimi i shënimeve është më rëndësi të veçantë për kryerjen më kohë dhe në afat të aktiviteteve të AKA-së, duke identifikuar statusin e marrëdhënies së punës për stafin akademik të angazhuar në Institucionet e Arsimit të Lartë. Ne këtë mënyrë bëhet e mundur identifikimi i punëdhënësit primar dhe sekondar.

Neni 5

Ofrimi i informatave

Për ofrimin e sakte te numrave personal të stafit akademik, Emrit dhe Mbiemrit, ATK, duhet ta freskoj regjistrin e vet me te dhëna nga Agjencinë e Regjistrat Civil (ARC) dy here ne vit.

Neni 6

Mënyra e Shkëmbimit të Informatave

5.1. Mënyra se si do te shkëmbehen të dhënat, kësaj marrëveshje do ti ketë te bashkangjitet një Procedurë Standarde te Operimit për shkëmbimin e shënimeve (zgjidhjen teknike), si dokument i veçantë e cila mund të ndryshohet apo plotësohet çdo herë që palët në këtë marrëveshje e shohin të nevojshme.

5.2. Kjo Procedurë Standarde e Operimit për shkëmbimin e shënimeve përshkruan procesin teknik të shkëmbimit të informatave.

Neni 7

Ruajtja e Informatave të Mbledhura dhe Mbikëqyrja

Palët pajtohen qe te dhënat qe do te shkëmbehen janë konfidenciale dhe si te tilla do te përdoren vetëm per qëllime te kësaj marrëveshje dhe vetëm brenda kornizës se saj. Ne rast te dyshimit

per shkelje te sigurisë se informatave te çfarëdo forme, pala e dëmtuar duhet te njoftoje menjëherë palën tjetër dhe se te dy palët rezervojnë me këtë rast te drejtën per te ndërprerë përkohësisht shkëmbimin e te dhënave pas çdo informacioni te besueshëm apo kërcënimeve tjera qe lidhen me sigurinë e Sistemit te Teknologjisë Informative te te dy institucioneve. Neni 7

Neni 8

Zbatimi i Marrëveshjes

1. Çfarëdo ndryshimi i mundshëm që mund të ndodh pas nënshkrimit të kësaj Marrëveshje, duhet të dakordohet paraprakisht nga Palët në formë të shkruar përmes anekseve të kësaj marrëveshje.
2. Çdo mosmarrëveshje eventuale ndërmjet palëve e cila nuk mund të zgjidhet me marrëveshje reciproke, do të zgjidhet nga Gjykata kompetente në Republikën e Kosovës.
3. Kushtet e kësaj Marrëveshje do të interpretohen në pajtueshmëri me ligjet e aplikueshme në Republikën e Kosovës.

Neni 9

Zbatimi dhe Hyrja në Fuqi

- 7.1. Palët nënshkruese u pajtuan që kjo Marrëveshje Mirëkuptimi të fillojë se zbatuari nga data e nënshkrimit me dhënien e mundësive palëve për vazhdimin apo ndryshimin e përmbajtjes se këtij dokumenti në çdo kohë, kur palët nënshkruese e konsiderojnë të nevojshme.
- 7.2. Kjo Marrëveshje Mirëkuptimi është e nënshkruar nga personat e autorizuar dhe është e hartuar në katër (4) kopje të njëjta, nga dy kopje për secilën nga palët nënshkruese.


Për: Administratën Tatimore të Kosovës



z. Sakip Imeri

Drejtor i përgjithshëm

Për: Agjencinë e Kosovës për Akreditim



z. Bekim Samadrixha

U.D. i Drejtorit të AKA-së

21/11/2017

Prishtinë

21/11/2017